



REPUBLIKA E SHOIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



Nr.1485 Regj.  
Nr 1485/4 Prot.

Tiranë, më 17.05.2022

## URDHËR

### **“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”**

**Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

**DREJTORISË RAJONALE TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR – TIRANË**

**ALESIO- 2014 sh.p.k**

*Adresa: Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga “Lord Bajroni”, Banese private Nr. 14*

**Për dijëni Kreditorit: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

*Adresa: Tiranë*

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat “JUS” sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër Regj 1485 me palë:

**Kreditor: INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

**Debitor: ALESIO- 2014 sh.p.k NUIS L41713003M**

**Objekti: Pagim Gjobe**

Une përmbarruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarrimore:

## KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv: **Vendim dënimi me gjobë Nr. 112 datë 08.06.2020 të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**, është përcaktuar detyrimi i palës debitore të paguaj shumën totale të detyrimit në favor të palës kreditore **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**, për dënimin me gjobë, në vlerën **2.000.000 lekë**, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjobën e pashlyer të përlloritur nga **Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit** në vlerën **1.200.000 lekë**. Tarifa përmbarrimore për shumën totale të detyrimit është në vlerën **307.200 lekë me Tvsh**

Për këtë titull ekzekutiv është lëshuar **Urdhrit të Ekzekutimit: Vendimi nr. 2367 datë 10.12.2021 i Gjykates Administrative Shkalle e Pare Tiranë**

Për ekzekutim të vendimit gjyqësor të mësipërm pala debitore është lajmëruar që detyrimin ta përmbushë në mënyrë vullnetare me shkresën e dates 01.03.2022. Pala debitore ka komunikuar për ekzekutim vullnetar të këtij titulli ekzekutiv.

Në datën **23.03.2022** në llogarinë e **Shoqërisë Përmbarrimore Private “JUS” sh.p.k** pranë **“RAIFFEISEN” BANK sh.a.** është kredituar në mënyrë vullnetare nga pala debitore vlera e pjesshme e detyrimit **2.080.000 (dy milion e tetëdhjetë mijë) lekë**

